



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 47, Datë 07 / 06 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 91, datë 21.09.2016, të bërë nga A.L, kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik, Mat në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “gjendjes civile”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

A.L në ankesën e saj deklaroi se: *“Ka qenë e punësuar pranë DSHP Mat që nga periudha 01.07.2009, në pozicionin si Infermiere e Edukim Promocionit, profesion të cilin e ka ushtruar me përkushtim, profesionalizëm dhe ndershmëri pa ndërprerje deri më datë 08.09.2016, kur me shkresën nr. 583, datë 07.09.2016 është njoftuar për fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. A.L pretendon se po diskriminohet duke e larguar nga puna për arsye politike pasi është bashkëshortja e B.L, anëtar i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe njëkohësisht dhe kryetar i seksionit nr.9 të grup seksionit Burrel, dega Mat në zgjedhjet e këtij subjekti në datë 29.04.2014”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e saj në vendin e punës.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë,*

përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe gjendjes civile janë shkaqe diskriminimi të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3/4 dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga ankuesja, A.L, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 866/2, datë 28.09.2016 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, DSHP Mat, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga A.L.

Me shkresën nr. 709, datë 03.10.2016, DSHP¹ Mat, informon Komisionerin se: *“A.L nuk është hequr nga puna për bindje politike por për thyerje të disiplinës në punë, shkelje kjo në mënyrë të përsëritur. Nga pesë kontrolle rutinë të ushtruara nuk është gjetur tri herë në punë”.*

- Me shkresën nr. 866/1, datë 28.09.2016, subjektit ankues iu kërkua që të dërgojë pranë Komisionerit, dokumentacion dhe informacion shtesë në lidhje me ankesën.

Me shkresën datë 05.10.2016 të dërguar në adresë të zyrës së Komisionerit, subjekti ankues ka dërguar dokumentacionin e kërkuar, në të cilin në mes të tjerash informon se: *“Për periudhën prej një viti (6/2015) që në drejtimin e DSHP, Mat është emëruar D.L, ka patur kontrolle selektive dhe me tendencë për arsye politike, me qëllim kontrollin e disiplinës në punë. Në datë 08.09.2016 në takim me drejtoreshën D.L, ka paraqitur raport mjekësor për paaftësi të*

¹ Drejtoria e Shëndetit Publik.

përkohshme në punë dhe punëdhënësi nuk mund të zgjidh kontratën sipas legjislacionit në fuqi. Kërkoj shqyrtimin e ankimit pasi në dijeninë time nuk më është komunikuar asnjë lloj shkresë apo mase disiplinore qoftë në mënyrë verbale apo me shkrim që të më lihej e drejta e ankimit konform normave ligjore”.

Me datë 07.12.2016, në zbatim të Urdhrit të Inspektimit nr. 187, datë 25.11.2016 u realizua inspektimi pranë subjektit, DSHP Mat. Nga ana e institucionit ishte e pranishme, D.L, me detyrë Drejtore e cila autorizoi F.M me detyrë Specialist i Burimeve Njerëzore për zbatimin e Urdhrit të Inspektimit. F.M informoi se: *“Për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datë 07.09.2016 për shkak të thyerjes së disiplinës në punë është larguar dhe punonjësja F.K. Masat disiplinore nuk janë të parashikuara në një dokument që ndodhet në zyrën e DSHP Mat dhe punonjësit nuk janë njohur paraprakisht me këto masa por janë vënë në dijeni sapo janë marrë këto masa disiplinore, të cilat janë komunikuar dhe në mënyrë verbale gjatë mbledhjeve që janë mbajtur. Për vitin 2014 në institucion nuk ka patur vlerësime të punës, ndërsa për vitin 2015 do jua vëmë në dispozicion”.*

- Me shkresën nr. 1052/2, datë 13.12.2016 nga ana e Komisionerit i është kërkuar subjektit DSHP Mat, dokumentacion shtesë në lidhje me: - Kopje të vlerësimit vjetor të punës 2015 për punonjësit: Xh.LI dhe L.V. - Kopje të faqes së parë të Rregullores së Brendshme të DSHP Mat dhe shkresës përcjellëse drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për miratim. - Kopje të proces verbalit të mbajtur mes palëve të datës 08.09.2016. - Kopje të dokumentacionit të zyrës së financës mbi mospagimin e ditës së punës të punonjësve të listuar në shkresën nr.358, datë 31.05.2016. - Kopje të bllokut të protokollit mbi emrat e punonjësve që kanë munguar në punë në datë 02.09.2015.

Me shkresën nr. 914, datë 16.12.2016 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, DSHP Mat, dërgoi kopje të dokumenteve të mëposhtme: - Kopje të dokumentacionit të zyrës së financës mbi mospagimin e ditës së punës të punonjësve të listuar në shkresën nr.358, datë 31.05.2016.

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:

Referuar librezës së punës, Nr. i regjistrit themeltar 10/41, lëshuar nga subjekti privat “Blendi” SHPK, Mat të subjektit ankues A.L, rezulton se që prej datës 01.07.2009 deri më 13.9.2016 ka vazhduar punën pa ndërprerje në detyrën si infermiere në shërbimin e higjenës pranë DSHP Mat. Këtë detyrë e ka kryer deri kur me Urdhrin nr. 25, datë 13.09.2016 *“Për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme e të justifikuar të A.L”* i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye se largohet brenda orarit të punës në mënyrë të përsëritur.

Pretendimi i ankueses se shkak për diskriminimin e saj është bindja politike dhe lidhja familjare me B.L, me detyrë Kryetar i Seksionit nr. 9 të grup seksionit Burrel të subjektit politik, Partia

Demokratike e Shqipërisë, dega Mat që është bashkëshorti i A.L, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

Referuar dokumentit: Certifikatë Familjare, nr. serie: 009939183, datë 21.09.2016 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Burrel, rezulton se shtetasja A.L është bashkëshortja e B.L.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DSHP Mat, rezulton se:

- Në librin e protokollit të DSHP Mat, në datë 02.09.2015, ora 08.15 të mbajtur në lidhje me prezencën në punë tek zyra e Higjenës, kanë nënshkruar si prezent në punë 15 punonjës dhe nuk figuron nënshkrimi i punonjësës A.L.
- Në librin e protokollit të DSHP Mat, në datë 15.12.2015, ora 12.15 të mbajtur në lidhje me prezencën në punë, kanë nënshkruar si prezent në punë 14 punonjës dhe figuron se punonjësja A.L ka munguar pa arsye.
- Në procesverbalin nr.358, datë 31.05.2016 të mbajtur në lidhje me prezencën në punë, figuron se A.L nuk ka qenë në vendin e punës.

Për sa më sipër, nga ana e DSHP Mat u paraqitën dokumentet e sipërcituara me anë të të cilave pretendohet se A.L ka shkelur disiplinën në punë në mënyrë të përsëritur dhe se është njoftuar dhe paralajmëruar për këto shkelje, por nga dokumentet e shqyrtuara rezulton se A.L nuk është paguar vetëm për një ditë pune në datë 31.05.2016 për mungesë në punë dhe nuk rezulton asnjë akt tjetër me të cilin të ishte njoftuar A.L për mungesë në punë apo marrjen e masave disiplinore për mungesë në punë.

Në lidhje me pretendimin e DSHP Mat² se për shkak të thyerjes së disiplinës në punë është larguar dhe punonjësja F.K, Komisioneri vlerëson se, referuar dokumenteve të sipërcituar, figuron se punonjësja në fjalë ka qenë prezent në punë në datë 02.09.2015 dhe ka munguar në dy rastet e tjera, pra është pushuar nga puna në të njëjtën ditë me ankuesen pavarësisht se ka patur vetëm dy mungesa në punë, ndërkohë që rezulton se punonjësi Xh.LI i cili kishte munguar në punë në të njëjtat data si punonjësja F.K nuk është marrë masa disiplinore me largim nga puna. Po ashtu rezulton se dhe punonjësja L.V ka patur dy mungesa në punë, por dhe për të nuk është marrë masë disiplinore për largim nga puna.

Nga sa më sipër rezulton që nga ana e DSHP Mat të jenë marrë masa disiplinore të ndryshme për thyerje të disiplinës në punë, por në të gjitha rastet nuk rezulton një dokumentacion në të cilin të vërtetohet se nga ana e punëdhënësit të jenë njoftuar punëmarrësit për marrjen e masave disiplinore.

Nuk ka rezultuar se ndaj A.L gjatë kësaj periudhe që ka punuar pranë DSHP Mat të jetë dhënë apo komunikuar ndonjë masë disiplinore, si tërheqje vëmendje, vërejtje apo paralajmërim për

² Referuar proces verbalit të inspektimit datë 07.12.2016.

largim nga puna, masa këto që më pas do të çonin DSHP Mat në marrjen e masës ekstreme për largim nga puna të A.L për thyerje të disiplinës në punë.

Në nenin 37 të Kodit të punës parashikohet se: *“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore”*. Në zbatim të këtij detyrimi DSHP Mat nuk vuri në dispozicion të Komisionerit ndonjë kontratë apo akt tjetër ligjor në të cilin të parashikoheshin shprehimisht procedurat dhe mënyra e marrjes së masave disiplinore. Pra, vërtetohet se ankuesja nuk ka qenë në dijeni të masave disiplinore të marra nga institucioni, për më tepër që njoftimi për fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënies së punës ka filluar 3 muaj pasi nuk i është paguar dita e punës për shkak të mungesës në punë.

Nga ana e DSHP Mat nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit asnjë akt, si procesverbal apo dokument tjetër që të pasqyrojë, rezultatet e takimit mes palëve të caktuar për tu mbajtur në datë 08.09.2016, ora 10.30 për të provuar zbatimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës. Referuar provave të paraqitura dhe pretendimeve të palëve evidentohet se nga ana e DSHP Mat, A.L asnjëherë nuk është vënë në dijeni apo të jetë analizuar për thyerje të disiplinës në punë, ashtu siç është e parashikuar në nenin 37 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, në të cilin citohet se: *“Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”*.

Përkundrazi për të provuar sjelljen tendencioze për largimin e saj nga puna, A.L ka faktuar se gjatë periudhës 08.09.2016 deri më datë 22.09.2016 ka qenë e pajisur me raport mjekësor³ nga Qendra Shëndetësore Burrel dhe nga ana e punëdhënësit pavarësisht raportit mjekësor është vazhduar procedura për largim nga puna.

Referuar dokumenteve të administruara në dosjen personale të punës së A.L vlerësohet se ajo ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj institucionit, pasi gjatë periudhës nga viti 2009 kur ka filluar punë si definitive deri në vitin 2016 që është larguar nga puna nuk është ndëshkuar asnjëherë me masë disiplinore dhe në asnjë rast nuk ka të dokumentuar se ka shkelur detyrimet kontraktore.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se disiplina në punë e A.L nuk ka qenë shkak i largimit të saj nga puna pasi në asnjë rast nga ana e DSHP Mat nuk u arrit që të paraqitej një dokument që të provonte mos përmbushjen e detyrave nga ana e A.L.

Në analizë të shkakut të pretenduar nga ankuesja dhe bazuar në nenin 82, pika 2, të Ligjit Nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, ku parashikohet: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në*

³ Nr. i regjistrimit 4373, Nr. serie 003392 Seria A/09 të lëshuar nga Q.SH.Burrel.

dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”, DSHP Mat nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova, që të vërtetonte se ankuesja është vënë në dijeni të thyerjes së vazhdueshme të disiplinës në punë, gjë që do të kishte ndikuar në performancën e dobët dhe mos përmbushjen e detyrave të A.L dhe se marrja e një mase ekstreme për largim nga puna përbën një masë proporcionale për të ndjekur një qëllim të ligjshëm.

Për sa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bindjen se veprimet e ndërmarra, nga ana e DSHP Mat, janë bërë në mënyrë të qëllimshme me synimin për largimin nga puna të subjektit ankues për shkak të bindjes politike të bashkëshortit të saj.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Theksojmë se diskriminimi për shkak të shoqërimit është një formë diskriminimi e parashikuar nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 4, ku sanksionohet: “*Diskriminim për shkak të shoqërimit, është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë*”.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1⁴, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjejmë se A.L, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e DSHP Mat, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen civile të ankueses.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 12 pika 1/c, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a) dhe c), si dhe neni 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁴ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, në formën e shoqërimit, të shtetases A.L, për shkak të gjendjes civile dhe bindjes politike të bashkëshortit të saj, nga punëdhënësi Drejtoria e Shëndetit Publik Mat.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e A.L në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI